



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3027/2024
Data: 22.04.2024

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tretë -III- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.03.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.
3. Statuti i QKMF-së -Hani i Elezit.
4. Propozim vendim për miratimin në parim të Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029 për Komunën e Hanit të Elezit.
5. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm.
6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022.
7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.
8. Raportimi i punës së Këshillave Lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2023.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hyriete Isufi thekson:- pikat të cilat nuk janë diskutua për shkak të mungesës së akterëve, kërkoj sqarim se çka ka qenë problemi.

Resul Suma thekson:- pikat të cilat nuk janë diskutuar për shkak të mungesës së akterëve në fjalë është se ftesa ju ka dërguar por arsyetimi ka qenë se nuk kanë pasur kohë për me marr pjesë në mbledhje, pra kjo bëhet fjalë për te drejtorët, ndërsa të këshillat e fshatrave dhe komitet konsultative prej momentin që ju ka ndaluar pagesa ata nuk kanë marr pjesë. Në fund të raportit e keni rekomandimin e përhershëm që drejtorët e drejtorive të marrin pjesë në mbledhje të komitetit për komunitet sipas pikave të parapara sipas planit të cilin e kemi të miratuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Statuti i QKMF-së –Hani i Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar që të bëhet statuti në formë unike për të gjitha komunat në nivel të Kosovës, mirëpo fatkeqësisht kanë kërkuar që me datë tridhjetë e një mars që të miratohet përfundimisht ky statut por materiali më është dërguar me vonesë dhe për me i zhvilluar të gjitha procedurat administrative fillimisht duhet ta shqyrtojmë në Kuvend dhe ta nxjerrim në diskutim publik e pastaj të miratohet në Kuvend. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:-komisioni për Statutin e QKMF-së ishte pjesëmarrës në mbledhje të Komitetit për Politikë e Financa dhe i paraqiti dy pika që duhet të ndryshohen. A na lejojnë afatet për shkak se në materialin i cili na është dërguar data tridhjetë e një mars është afati i fundit për miratimin e këtij statuti. Është mirë që të bashkëpunoni me stafin për shkak se ata deklaruan që duhet të themelohet komisioni që nuk e keni.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- Ministria e Shëndetësisë ka rekomanduar që deri më datë tridhjetë e një mars të miratohet por faji nuk është i imi për shkak se materiali më është përcjell me vonesë dhe për me i zhvilluar procedurat na duhet patjetër të shkojmë sipas rregullores në mënyrë që të del në debat publik dhe pasi të merren propozimet nga debati publik do të përcillen për Kuvend. Sa i përket bashkëpunimit përveç këshillit të pacientëve që duhet ta themelojmë me këtë statut se nuk e kemi pasur por do të shikojmë se për cilin komision bëhet fjalë.

Malik Berisha thekson:- specialistë të mjekësisë familjare nuk kemi por janë edhe disa drejtime tjera si radiologu. A keni menduar për çështjen të specializimit të mjekësisë familjare për shkak se shumica mungojnë prej tyre.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- jeni në dioni se sa i përket specialistëve të mjekësisë familjare asnjë studentë i ri nuk ka qëllim për me specializuar në drejtimin specialistë i mjekësisë familjare për shkak se kemi shprehur vullnetin për me i mbështetur prej komunës së paku një specializantë çdo pesë vjet të jetë prej komunës sonë por fatkeqësisht interesimi i mjekëve nuk është te mjekësia familjare dhe kjo është arsyeja që nuk kemi mjek familjarë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kjo pikë përcillet për debat publik.

4. Propozim vendim për miratimin në parim të Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029 për Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- plani lokal i veprimit për cilësi të ajrit është plani i parë prej se është themeluar komuna i cili trajton në mënyrë të strukturuar problematikën e ndotjes së ajrit në territorin e komunës së Hanit të Elezit. Sipas Ligjit për Cilësinë e Ajrit të gjitha komunat janë të obliguara për me i hartuar planet për cilësi të ajrit dhe në këtë drejtim edhe komuna jonë me mbështetjen teknike të Uendipisë. Ky plan në mënyrë të qartë adreson burimet e ndotjes së cilësisë së ajrit si dhe nivelet e ndotjes së ajrit siç janë industrinë, Sharrcemi pastaj qarkullimi i madh i veturave dhe maunave në territorin e komunës sonë, amvisëria për shkak të përdorimit masiv të drurit si lëndë djegës gjatë sezonit dimërorë, mbeturinat, përdorimi i pesticideve si dhe plerave artificiale në tokat bujqësore. Ky plan në mënyrë të qartë përcakton aktivitete, objektivat dhe veprimet e realizimit të cilave mund të ndikoj në uljen e nivelit të ndotjes së ajrit. Planin është hartuar për periudhën kohore prej pesë viteve. Diskutimi publikë për këtë plan do të zgjatë tridhjetë ditë në kuadër të së cilës do të mbahet edhe shqyrtimi kryesorë kryesor publik. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë pyetje mund të parashtroni.

Resul Suma thekson:- objektivat të cilat ishin të paraqitura shpresoj që edhe të financohen se shuma ishte 202 ,000.00 € që për komunën tonë është e kushtueshme. Përveç objektivave e pashë që ishin rritja e hapësirave të gjelbërta dhe e kam diskutuar edhe me drejtorin e bujqësisë që në dy fshatrat e komunës së Hanit të Elezit është bërë një punë shumë e mirë që është pyllëzuar në dy pjesë por un kam dëshirë që në këtë plan të jetë e parë ruajtja dhe kultivimi i tyre.

Sherif Berisha thekson:- është mirë të shikohet mirë Ligji se ku jeni bazuar. Unë kam pasur propozim konkretë rreth ndotjes së ajrit që komuna jonë me pasur person adekuat të kësaj lëmie që me bërë matjen e ajrit. Planin që na është përcjell nuk shkruan askund çështja e azbestit që është një prej ndotësve që është ende e evidentë në komunën tonë sepse pavarësisht ndotjes së ajrit prej Sharrcemit edhe asbesti ndikon në sëmundjen e personave me kancer.

Nexhmedin Daci thekson:-sa i përket matjes së cilësisë së ajrit ne e kemi paraparë vendosjen e dy stacioneve në lokacione të ndryshme dhe janë planifikuar në vitin 2026 . Sa i përket asbestit hynë në kuadër të industrisë por ky është draft dhe ne mundemi me plotësuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kjo pikë përcillet për debat publik.

5. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- ky propozim vendim ka të bëjë me shpalljen me interes të përgjithshëm publik të një pjese të parcelës P-73317019-01378-0 në sipërfaqe prej 9234 m² (sipërfaqe e përgjithshme e parcelës 13525 m²) në vendin e quajtur Rudine, zona kadastrale Gorancë-Hani i Elezit me kulturë tokë jopjellore, pronë shoqërore P.SH Ekonomia e Pyjeve. Këtë parcelë e kemi përzgjedhë sit ë përshtatshme për ndërtimin e deponisë së mbetjeve të ngurta. Ju e dini që vazhdimisht komuna jonë ka pasur problem me mbetjet e ngurta nga rrënimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore. Si hap i parë për çështjen e deponisë kërkohet shpallja me interes të përgjithshëm të parcelës dhe me kujdes e kemi përzgjedh këtë parcele sepse në bazë të normave teknike të planifikimit respektivisht të kapitullit të katërt neni shtatëmbëdhjetë një lokacion për tu përzgjedhur duhet ti përmbushë disa kushte dhe ky lokacion që e kemi përzgjedhë i plotëson gjitha kushtet teknike. Pasi që pacela nuk është pronë e komunës duhet me i bërë kërkesë Qeverisë për me najë dhënë pëlqimin për shfrytëzimin e kësaj parcele për ndërtimin e deponisë. Materialin e keni të kompletuar dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela thekson:-ju përgëzojë për këtë vendim për deponitë e ngurta dhe e dijë atë vend edhe për çështjen e infrastrukturës rrugore dhe në sezonin dimërore dhe pranverore është rrugë e pa kalueshme. A e keni paraparë që të ndërtohet edhe infrastruktura rrugore deri te vendi ku duhet të hedhen mbeturinat e ngurta. Atë zonë e kemi shfrytëzuar edhe më herët për eliminimin e kafshëve me sëmundje të brucelozës dhe është mirë që mos të preken edhe mbeturinat prej azbestit për shkak se janë në afërsi për shkak se janë të rrezikshme.

Refet Kalisi thekson:- ky vendim na ka munguar deri sot se nuk e kemi pasur dhe ju përshëndes për këtë vendim që është marr, ndoshta do të jetë problem për Hanin e Elezit sepse është bukur larg por atje është vendi dhe është vendim i qëlluar. A do të menaxhohet prej komunës për shkak se duhet me pasur mjete financiare.

Nexhmedin Daci thekson:- parcela është aty ku është deponuar azbesti, ndërsa sa i përket rrugës është çështje e projektit dhe projekt nuk kemi bërë por vetëm jemi përcaktuar për lokacionin . Hapi i parë është që Kuvendi ta miraton që atë parcelë me shpall me interes të përgjithshëm, hapi i dytë është marrja e pëlqimit prej Qeverisë , hapi i tretë është hartimi i projektit, hapi i katërt është pëlqimi mjedisorë nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë dhe pastaj realizimi dhe natyrisht që do ta kemi parasysh edhe rrugën. E kemi paraparë që kompania për me u kujdesur por natyrisht duhet me sektorin e mjedisit dhe shërbimet publike.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022 ka rezultuar me opinion të pa modifikuar dhe me pesë rekomandime apo me pesë të gjetura dy prej tyre kanë qenë të përsëritura, dy gjysmë të përsëritura dhe një prej tyre e gjetur e re. Prej këtyre pesë të gjeturave e kemi gjetjen e parë e cila kishte të bëjë me tejkallimet në furnizim nga sasi dhe komunalit e cila është tërësisht e zbatuar. E gjetura e dytë ka të bëjë me vonesën e obligimeve financiare, kjo e gjetur është pjesërisht e zbatuar. E gjetura e tretë rritja e llogarive të arktueshme , kjo e gjetur është e zbatuar tërësisht. E

gjetura e katërt është zotimet e mjeteve dhe urdhërblertjeve në SIMFK pas pranimi të faturave, është zbatuar tërësisht. E gjetura e fundit është përbërja jo e plotë e komisionit dhe përdorimit jo standardë i formularëve në procesin e mbështetjes financiare të organizatave joqeveritare, edhe kjo e gjetur është plotësisht e zbatuar.

Resul Suma thekson:- te çështja e pestë që potencohet se komisioni duhet t'i ketë pesë anëtarë dhe në bashkëbisedim me disa koleg e pashë që në komunat tjera të gjitha komisionet që i kanë për të cilat bëhet fjalë për subvencion të OJQ-ve kanë përfaqësues edhe nga Kuvendi i Komunës që është e ligjshme dhe e plotëson numrin.

Lindita Ballazhi thekson:- kjo ka të bëjë për vitin 2022 dhe komisionet ishin vetëm prej tre anëtarëve dhe kjo e gjetur është zbatuar plotësisht gjatë vitit 2023 që në vend të tre anëtarëve përbërja është ashtu siç e parasheh Ligji dhe rregulloret në fuqi, ndërsa për përbërjen e anëtarëve do ta marrim si rekomandim nga ana e juaj.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

1. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- për vitin 2023 janë mbajtur gjashtë mbledhje të këshillit komunal për siguri në bashkësi. Temat të cilat janë diskutuar gjatë vitit 2023 janë të ndryshme që kanë të bëjnë me çështje të sigurisë në Komunën e Hanit të Elezit. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- përsëri do ta ngris çështjen e dukurive negative nëpër shkolla dhe një pjesë tjetër në qendër të Hanit të Elezit. Kërkoj që me policinë të bisedohet çështja e lirim të trotuareve në qendër të Hanit të Elezit për shkak se është shqetësim se nuk po kemi ka me ecur. Policia duhet të jetë efikase në punët e veta për me i kryer por edhe në rastin e grabitjeve që po bëhen dhe është dukuri e shfaqur por duhet të zbulohen këto raste që po ndodhin.

Mehmet Ballazhi thekson:- këtu bëhet fjalë për temat të cilat janë diskutuar dhe është diskutuar më shumë se temat të cilat janë shënuar këtu por brenda kësaj është edhe çështja e dukurive negative të cilat jemi munduar mi trajtuar qoftë përmes mbajtjes së ligjëratave nëpër shkolla dhe në Shtëpinë e Kulturës kemi mbajtur takime të tilla për parandalimin e dukurive negative por me gjithë atë mundë t jenë evidente edhe në të ardhmen por jo që i neglizhojmë këto tema për arsye të sigurisë së komunitetit të Komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- çështja e parkingjeve që janë bërë a i ka bërë një lloj eksperti sepse po më doket që ka shumë parkingje me vend të rezervuar për të hendikepuarit.

Mehmet Ballazhi thekson:- është kriter i cili duhet të plotësohet në kuadër të gjitha parkingjeve në Han të Elezit, ka kërkesa prej OJQ të Hendikosit që na të kemi parkingje edhe më shumë se këto që janë. Parkingje të mjaftueshme ka.

Sherif Berisha thekson:- ka qenë kërkesë e më hershme që me u zgjeruar hapësirat për personat me nevoja të veçanta por edhe trotualet janë shumë të larta dhe me mundësi për me u zvogëluar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

2. Raportimi i punës së Këshillave Lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- është një raport i përgatitur dhe përpunuar së bashku me këshillat e fshatrave. Gjatë vitit 2023 jemi takuar dhe kemi mbajtur takime të rregullta. Sfidë ka qenë që me hyrjen e Ligjit të Pagave në fuqi nuk kemi mundur me gjet hapësirë që me i kompensuar për takimet që i kemi mbajtur, mirëpo gjatë këtij viti do të mundohemi me bërë zgjidhje.

Erblin Meliqi thekson:- raporti i këshillave të fshatrave ke për takimet të cilat janë mbajtur dhe si Kuvend e kemi diskutuar edhe më herët që administratori i Hanit të Elezit ka dhënë dorëheqje por vetë administratori pohon që grupi ku ka qenë prezentë tek ju ka dhënë dorëheqje dhe nuk e di çka ka më zyrtare për me pa që nuk është i interesuar për atë pozitë.

Natyra Kalisi thekson:- me datë tetëmbëdhjetë dhjetorë të vitit 2022 e ka shënuar një mesazh në vajber në grupin tonë, mirëpo ajo e cila nuk qëndron është në procesverbalin e këshillave lokal të vitit 2023 ku në mbledhjen e parë ka marr pjesë i njëjti person. Në mbledhjen e fundit të cilën e kemi mbajtur me shtatë mars 2024 personi në fjalë nuk ka marr pjesë në takim kemi diskutuar, biseduar dhe ka dhënë dorëheqje dhe fletën e dorëheqjes e kemi në rast se dikujt i nevojitet dhe e vërteta është një letër zyrtare e cila nevojitet. Po ashtu në shejë falënderimi për kontributin e kryetarit të këshillit lokal për Hanin e Elezit gjatë këtyre dy viteve ja kemi dërguar edhe një letër falënderimi për kontributin për shkak se sa ka qenë Kryetarë i Këshillit Lokal bashkëpunimin me mua dhe me ekzekutivin e ka pasur në nivel

Erblin Meliqi thekson:-është e vërtet që me datë tetëmbëdhjetë dhjetorë të vitit 2022 ka dhënë dorëheqje në grup në vajber dhe është e vërtet që potencove që është në procesverbal që ai ka qenë prezent por a është e mjaftueshme që gjatë dymbëdhjetë mbledhjeve gjatë vitit vetëm një mbledhje me qenë prezent administratori i asaj zone ku është më e populluar prej krejdve dhe si drejtori është dashur me marr masa ndaj tij se nëse është për me punuar për me i zgjidh problemet e qytetarëve është në rregull, mirëpo nuk po më duket në rregull që vetëm me një mbledhje me marr pjesë brenda vitit nuk është në rregull.

Natyra Kalisi thekson:-po më vjen keq që ndoshta bazën ligjore të rregullores dhe udhëzimit administrativ nuk e keni rregulluar për shkak se takimet që duhet të mbahen me këshillat lokal janë minimumi gjashtë takime brenda vitit e jo dymbëdhjetë.

Xhevahir Dernjani thekson:-këshillat lokale duhet ta luajnë rolin e vetë me qenë se edhe prej tyre kërkojmë që sa më tepër kërkesat e komunitetit ati ku jetojnë sepse e kanë një rolë se adresojnë deri te kuvendi apo drejtoritë kërkesat në lidhje me komunitetin. Këshillat duhet të punojnë dhe të jenë më transparentë se ka nevojë komuniteti pastaj takimet publike që i kemi që kërkesat e tyre për me i adresuar në drejtoritë përkatëse.

Refet Kalisi thekson:-sa i përket administratorit të Hanit të Elezit ai nuk ka dhënë kurfarë kontributi dhe nuk e di a ka qenë në takime apo a ka propozuar diçka apo a ka pasur ndonjë kërkesë prej qytetarëve edhe pse kur është zgjedhur është zgjedhur normal me vota por interesimi i tij ka qenë shumë i dobët.

Natyra Kalisi thekson:- është konstatim i gabuar për shkak se kemi pasur kërkesa, ankesa prej anës së administratorit dhe shqetësimet e ndryshme nga qytetarët të cilët i ka marr dhe ne kemi kërkesat e protokolluara nga administratori apo në takimet që ka ngritur çështjet e ndryshme si për mbeturina, ndriçim, për energjinë elektrike dhe gjitha aspektet e tjera infrastrukturore. Kryetari i këshillit lokal të Hanit të Elezit ka punuar dhe ka dhënë kontributin e tij me aq sa ka pasur mundësi për shkak se askush nuk vjen me kryer ndonjë punë vullnetare siç kanë ardhur këshillat lokale.

Kryesuesi thekson:- informata paraprakë që u potencua pas mos funksionit nga viti 2019 nuk qëndron se unë vet kam qenë administratorë dhe për shkak pandemisë nuk kemi mundur me u rizgjedhur dhe ishin funksional të gjithë administratorët e secilit fshatë, kanë vazhduar me bërë punën siç e kanë bërë brenda afatit ligjorë. Nuk është mirë me i humbur kontributi atyre administratore që në kohën më të vështir janë ballafaquar me ndonjë rrezik të kovidit dhe punën në fakt e kanë bërë. Ne kemi qenë në qeverisjen e kaluar dhe për shkak të kushteve jo të favorshme nuk kanë mundur me u rizgjedhë administratorët në afat të caktuar. Në informatë vazhdimisht thuhet me kryetarët e këshillave lokal që kjo për mua është një e pa vërtetë për shkak se edhe drejtoresha e pranojë në fund që administratori ka dhënë dorëheqje 18.12.2022 gjë që kurrë nuk e ka pranuar tek deri në mbledhjen e më hershme të KPF-së. Nuk e fajësojë drejtoreshën kur një administratorë jep dorëheqje por unë e fajësojë kur ajo me çdo kusht donë me dal mirë në tituj të telegrafit shembull a faktikisht qytetari nuk është me administratorë. Është një administratorë me mbi katër mijë banorë që ka pasur nevojë me qenë funksional. Nuk është turp me potencuar që ka dhënë dorëheqje administratori se është gjë normale dhe u zgjedhke tjetri por vazhdimisht të potencohet që administratori është kur ai ka dhënë dorëheqje në grup që sot edhe mesazhi është një far shkrese zyrtare por nuk është pranuar deri në këto ditë prej drejtoreshës. Është fakt që drejtoresha ka dashur ta përmbylle me një far mënyre ti mbuloje fjalët e veta vazhdimisht që ishin gënjeshtër për mu si kryesues dhe të gjithë qytetarët vazhdimisht kanë qenë të mashtruar sepse faktikisht nuk kemi pasur administratorë. Mesazhin e z.Mirsad Qajani të cilin dje e kam pranuar që potencon që me datë 18.12.2022 ka qenë data dhe dita që kam shënuar në grup të cilën këtë mund ta vërtetoni përmes shkrimeve të mia në grup, ka qenë dorëheqja dhe largimi nga pozita e administratorit dhe arsyeja e largimit siç e kam shënuar edhe në dorëheqje ishte personale për shkak se nuk kisha mundësi të marr pjesë në takime sepse punoja në Shkup. Kam pasur edhe një takim pas dorëheqjes sime te komuna por ai ka qenë më shumë informues vetëm sa për procesverbal, kjo ishte e gjitha çka do që flitet mbrapa nuk është e vërtetë se nuk kam pasur interesime sepse jam larguar nga Kosova dhe kjo është e vërteta dhe nuk ka më shumë për me shtuar.

Natya Kalisi thekson:- institucioni më i lartë është letra zyrtare apo një imell me shkrim në imell zyrtarë sepse tash ne punojmë me ligje të Kosovës dhe i respektojmë ato, letra zyrtare për dorëheqje duhet të ipet në mënyrë elektronike, apo në mënyrë me shkrim. Arsyeja që ju potencuar në lidhje e atë se ka marr pjesë në takim vetëm formalisht për shkak se është procesverbali i mbledhjes së para të viti 2023 por është mendimi i juaj të cilin unë e argumentova për shkak se pasi jep dorëheqje dikush nuk vjen në takim vetëm hajt kotë po vijë në takim, mirëpo vjen në takim për me marr pjesë dhe për me dhënë kontribut siç e ka dhënë në takimin e mbledhjes së parë në të cilën ka ngritur shqetësimin në lidhje me parkingun e QKMF-së e kështu me radhë. Imelli zyrtarë ka ardhur me datë 07.03.2024 të cilin e marr për bazë dhe kemi bërë letër falënderimi dhe brenda tridhjetë ditëve pas dorëheqjes do të thirret komisioni dhe do të fillojnë zgjedhjet.

Kryesuesi thekson:- dorëheqjen a ta ka sjellë me postë apo me shkrim dhe mesazhin që ta ka përcjell çka është për ty.

Natya Kalisi thekson:- përmes postës elektronike. Grupin në vajber të cilin e kemi nuk është zyrtarë dhe zyrtarë është imella zyrtare përmes postës elektronike.

Kryesuesi thekson:- është mirë që të lexoni pak më shumë sepse sot mesazhi është zyrtarë. Nuk është patjetër që me çdo kusht me dal mirë drejtoreshë se je ti gënjyer dhjetë mijë banorë dhe faktikisht qytetari e dinë a ka dhënë dorëheqje apo nuk ka dhënë .

Natya Kalisi thekson:-nuk kisha dashur me u zgjeruar dhe nëse doni ua përcjelli të gjitha dokumentet të gjithë anëtarëve të asamblesë dhe mundeni me shqyrtuar këtë rast dhe mundeni me i plasuar edhe nëpër rrjetet sociale për me i informuar më saktësisht.

Kryesuesi thekson:-drejtoreshë unë ty të kuptojë dhe është fakt që ti shumë lehtë e ke se ty nuk je skuqur para qytetarëve dhe nuk e dinë si ke ardhur këtu dhe shumë lehtë i trajton këto gjëra pa pikë turpi dhe me çdo kusht donë me mbrojtur diçka që pa pasur nevojë me mbrojtur .

Mehmet Ballazhi thekson:- unë edhe në mbledhjen e kaluar e kam potencuar se hapësira e kuvendit, mikrofonat dhe ekranet televizive nuk duhet të shfrytëzohen për tu paraqitur kinse po bëjmë diçka dhe ne po flasim për çështje zhvillimore, çështje procedurale, juridike dhe nëse ka një procedurë që i shkelë rregullat qofshin ligjore apo procedurale tjera ka institucione dhe nuk është kuvendi që duhet të diskutohet se kush është më oratorë dhe kush nuk është më oratorë . Besoj që janë çështje të procedurave dhe nuk është momenti i debateve dhe konflikteve brenda një diçkajit që ka një rregull që e përcakton qoftë edhe për çështjen e kryetarit të këshillit lokal të Hanit të Elezit pra janë çështje juridike që mund të zgjidhen por jo çështje parlamentare që mund të flasim këtu sa për të treguar se po flasim diçka.

Zaim Bela thekson:- nuk e di unë personalisht që në takimet të cilat i kemi mbajtur se është negociuar paga por të gjithë kanë qenë vullnetarë të cilët kanë dashur me u zgjedh për me përfaqësuar fshatin dhe në bazë të raportit të ciline keni përcjell del se asnjë kërkesë për shkak se më herët kemi pasur raporte por ka pasur neglizhenca prej disave që nuk kanë punuar shumë por me ndihmën e drejtorit apo dikujt tjetër kanë hartuar raport dhe kanë treguar që kanë pasur takime dhe kërkesa. Në bazë të raportit shihet se nuk është punuar dhe pagesa edhe më herët nuk ka qenë por edhe nuk është negociuar pagë që ty ke me u zgjedhur administratorë dhe ke me pasur këtë pagë por është bërë në mënyrë vullnetare. Mundësia për me i paguar më herët nuk ka qenë e tash a mundeni ju me i paguar unë nuk e di dhe nuk ka nevojë që një administratorë qe dy vite gati po bëhen që ka dhënë dorëheqje dhe nuk mundet me u zgjedhë por së paku me qenë sa më transparent dhe me fol para qytetarëve se nuk po e di unë kur ka dërguar imell por është diskutuar shpesh herë në kuvend se administratori që e përfaqëson komunitetin e Hanit të Elezit ka dhënë dorëheqje. Pse mos me u ftuar dhe me marr iniciativë për me zgjedhë një administratorë tjetër.

Kryesuesi thekson:- ne jemi në shërbim të qytetarit dhe do të ishte më e ndershme që të jemi më transparentë dhe nuk kemi nevojë me reklamuar vetën që jemi tu punuar a shërbimi qytetarit nuk i bëhet.

Mehmet Ballazhi thekson:-secili e bënë punën e vetë aq sa dinë dhe drejtoresha e ka bërë punën e vetë perfekt në përgjegjësitë që i ka, a ka mundur me qenë koha shumë e gjatë për me u zgjedhur apo mos me u zgjedhur është çështje tjetër por ne flasim për procedura por nuk po flasim me një anarki parlamentare siç po na i merr mendja neve dhe nuk po flasim në aspektin politikë por po flasim në aspektin procedural pra është e përcaktuar se çka është zyrtare dhe çka nuk është zyrtare dhe ne jemi normalisht për interesat e qytetarëve.

Kryesuesi thekson:-nuk dua dikën që ta qes keçë por një vit e katër muaj ka pasur fjalë të pa vërteta.

Natya Kalisi thekson:-nuk kemi negociuar me askënd dhe as nuk negociojmë por është ligji ai i cili negocion me ne dhe me ato por nëse e keni lexuar rregulloren komunale për organizimin e vendbanimeve dhe këshillave lokal atëherë është e qartë, kompensimi i këshillave lokal bëhet për gjashtë takime të mbajtura brenda vitit kalendarik dhe të njëjtit paguhen në shumë ekuivalente të komiteteve obligative e ju po thoni që unë duna me negociuar por faktikisht është Ligji ai që e përcakton. Nuk është qe ne nuk duam me kryer por duhet t'i ndjekim procedurat administrative me rregull.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- asambleja ka votuar për me u zgjeruar edhe për një drejtori por nuk e di a ka nevojë edhe për një drejtori për kulturë rini dhe sport sepse në gjitha këto evenimentet që ndodhin nuk i shohë kategoritë e luftës dhe nuk i di arsyet se a bashkëpunohet për shkak se nuk e pashë as Kryetarin e Invalidëve të Luftës , as të Veteranëve të Luftës. Në listë të pagave te arsimtarët, a ka arsimtarë që nuk janë arsimtarë e që marrin pagë. A keni pranuar dikush prej drejtoreshave dhuratë prej Kompanisë Sharrcem. Sa prej personave ju është premtuar që kanë me u punësuar në çerdhe përmes kompanisë Sharrcem se është përmendur te Lagja Livoreka, Vilëve , Hasallarëve pra bëhet fjalë te drejtorja e arsimit. Te rekomandimi i pestë a do të shkon përsëri në atë formë subvencionimi dhe a do të përmirësohet ai rekomandim. Në mbledhje të KPF kam parashtruar një pyetje për çështjen e dronit por nuk e kam marr përgjigjen.

Arbenita Bajramaliu thekson:- gjatë organizimeve ne ju bëjmë ftesë gjithëve pa dallim dhe personalisht ju kam bërë ftesë të gjithëve ndërsa për pjesëmarrjen unë nuk e di.

Sherif Berisha thekson:- ju duhet të i ftoni ata dhe të bisedoni me to sepse po e shohë që gjithmonë kur po bëhet ndonjë subvencionim apo donacion edhe këto kategori marri dhe e shohë të arsyeshme që të bisedohet për ditët që janë të shënuara të bisedoni me ta që udhëheqja të jetë prej tyre.

Arbenita Bajramaliu thekson:- është shumë e vërtetë se ne vetëm e kemi filluar një bashkëpunim me secilin prej tyre i kemi ftuar për çdo çështje që e kemi mbajtur deri tash dhe është e drejtë e tyre se a vijnë apo nuk vijnë.

Hisni Luri thekson:- nuk ka persona në listë pagave që nuk janë arsimtarë e marrin pagë. Te çerdhja nuk i kemi premtuar vende të punës. Ne e kemi pasur një mundësi prej kompanisë Sharrcem që ata na e kanë premtuar që një pozitë për shkak të kërkesave dhe nevojave që i kemi për shkak të numrit të vogël të edukatorëve që i kemi është e pamundur me i pranuar fëmijët dhe kemi bërë kërkesë në Sharrcem dhe na kanë premtuar .

Mehmet Ballazhi thekson:- për premtime kur potencoi është mirë me përmendë që kush kujt i ka premtuar sepse këto mund të ja kishe premtuar dikujt ti e na nuk e dimë por është mirë me dëshmuar me diçka. Kur të potenconi se a ka marr ndonjë drejtoreshë dhuratë prej kompanisë Sharrcem por mund të themi se a ke marr ti dhuratë prej dikujt brenda këtij viti dhe kjo nuk është pyetje për me pasur një dyshim dhe nëse keni ndonjë bazë që ka bazë korruptive mund të potenconi drejtorin në fjalë që ka pranuar dhuratë. Nuk ka asnjë dron të regjistruar në komunë e çka është ka të intereson ty unë nuk po e di se çka donë me ditë por nuk ka asnjë dron dhe pse na kryejmë shërbime për investimet që i kemi bërë në infrastrukturë me një dron atëherë është diçka tjetër.

Sherif Berisha thekson:- besoj që kam drejtë të parashtojë pyetje dhe besoj që nuk e di se kujt i pengojnë këto pyetje sepse ishin të drejtë për drejta që i parashtrova e pse nuk keni përgjigje unë mbesë pranë këtyre. Te çështja e dronit kam parashtruar pyetje sepse në bazë të faturave nuk figuron por unë dua ta dijë se kënd e paguan për me bërë atë ingjizim pasi që nuk është i juaji.

Mehmet Ballazhi thekson:-ne duam të jemi transparentë ndaj qytetarëve dhe kur po bisedojmë jashtë seancave ju po potenconi se duhet me fol diçka në Kuvend dhe brenda Kuvendit pastaj potenconi diçka tjetër , potenconi drejtor por duhet ta thoni se për cilin bëhet fjalë që ta dimë edhe na se kush ka pranuar ndonjë shpërblim nga dikush potencojë ose denoncojë në polici ose në organet hetuese. Mos i merr këto për tu prononcuar në televizion sa me potencuar se një anëtarë i VV-së paska potencuar këtë çështje por kjo është çorientim për qytetarët. Koha më e madhe na zgjatë për një çështje që absolutisht nuk ka të bëjë me zhvillim dhe ne e kemi provuar disa herë që me çështjen zhvillimore jemi marr pesë minuta ndërsa me çështje e qenve endacak tri orë, mirëpo mos ta bimë nivelin e këtij kuvendi deri aty që të merremi me çështje që absolutisht nuk kanë asnjë esencë në zhvillim të këtij vendi.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket rekomandimit numër pesë unë edhe më herët potencova se gjatë viti 2023 kjo e gjetur është zbatuar plotësisht.

Resul Suma thekson:- te kultura e kam një shqetësim se a ka mundësi që atë ditë që është festa me u festuar qatë ditë se po më doket humbje kohe edhe te nxënësit se humbin ditë mësimi dhe sot i kanë orët e shkurtuara për shkak të manifestimit dhe nesër e kanë pushim pra ju vjen dy dytë rend me humbë mësim. E kam parë që secila shkollë e ka shpallë mësuesin më të mirë por cilat ishin kriteret për përzgjedhjen e mësuesit më të mirë dhe a ka pasur ankesa. Në qytet po ka gropa dhe është mirë drejtoria e urbanizmit me i rregulluar. Projekti te kufiri ka filluar nga shtatori apo nëntori i vitit të kaluar dhe u diskutua çështja e lokaleve dhe që në fillim jam kanë kundër për me i prishur dhe u vendosur me i prishë dhe tash u bë muaji prill dhe nuk janë prishur pra janë në dilemë se çka është tu ndodhur me lokalet e tyre. Përveç lokaleve te kufiri janë edhe disa në qytet çka do të ndodhe me këto lokale a ka ndonjë afat, datë apo projekt për shkak se nuk po e dinë a me investuar në lokal apo mos me investuar.

Mehmet Ballazhi thekson:- këto që i diskutove tash i kemi diskutuar një ditë bashkë nëse të kujtohet dhe ke pasur sqarime. Për çështje të lokaleve që je kundër e që ke diskutuar edhe tjetër kund është çështje e projektit dy vjeçar 2024 dhe 2025. Kërkesa ka qenë për me u rrënuar ata lokale në vitin e kaluar për personat e ndërgjegjshëm po flasim dhe tash kur ka persona të pandërgjegjshëm e shfrytëzojnë politikisht dhe të frustronjë edhe ty tani është pak problem se është dashur në fakt me kryer ata lokale edhe më herët sipas urdhërësës që është dashur me i larguar ata lokale. Tash janë procedurat ligjore që janë nxitë për me bërë ankesa dhe ne i kemi pritur mos me bërë skandale dhe skena që është pritur me i bërë. Në vend që të ndihmohet në zhvillimin e projekteve bëhen skena dhe për atë është mirë jo me bërë skena por me ndihmuar në zhvillimin e projekteve e jo me bërë propaganda për me u ndal projektet. Edhe kjo pjesa e gropave është e vërtetë që janë riparuar gypat e ujit që ka pasur prishje dhe tash është procedura për mbylljen e gropave.

Hisni Luri thekson:- me rregullore festat e ditës së shkollës ju takon e lirë dhe sa i përket kremtimit një ditë përpara zakonisht ka qenë traditë që të bëhet aktiviteti me nxënësit që nuk është humbje por është dobi që edhe nxënësit kanë nevojë për motivim për me i shfaqur talentet e tyre qoftë në valëzim, art, muzikë dhe lëndë tjera. Sa i përket mësuesit të vitit kriteret i ka përcaktuar Ministria e Arsimit dhe është fat i mirë që kemi pasur konkurrencë por jo me pasur ankesa dhe nuk di që ka pasur ankesa por edhe po të kishte ankesa nuk duhet të drejtohen në Kuvend por në drejtori të arsimit por nuk ka pasur. Diçka që ka qenë e mirë se në këtë vit i kemi pasur dy garues të mirë dhe kriteret që i ka përcaktuar Ministria e Arsimit ka qenë çështja e aktiviteteve e që dikend e ka bërë pak më të dalluar.

Zaim Bela thekson:- numri i punëtorëve që është bërë kontrata me Islamik Relief Kosova dëgjova që një mjekë është me orar të shkurtuar që vjen nga Maqedonia. A është menduar se në territorin e Komunës së Hanit të Elezit ka diell 250 ditë brenda vitit dhe a është menduar për panele solare për shkak se ka fonde nëse i lejon Bashkësia Ndërkombëtare se në territorin e Hanit të Elezit ka diell të mjaftueshëm që është e mundshme që mos me bërë ndotje gjatë ngrohjes me dru zjarri por mund të shfrytëzohet energjia elektrike pa mjete financiare.

Xhevahir Dernjani thekson:-sa serra janë ndarë dhe a ka qenë kërkesa më e madhe për serrat e biznesit. Ne e dimë që tetë marsi është festa e gruas a ka marr ndonjë hap që të ju shpërndahet ndonjë lule dhe a kanë menduar që biznesi të jetë më i madh. A ka komuna organizatë joqeveritare që ndoshta mundet edhe at ty ofrojë dhe stimulojë më tepër me shtimin e numrit të punëtorëve.

Sherif Berisha thekson:- ETC-ja, Viva fresh dhe pjesa përcjellëse që është te Viva a i paguajnë tatim komunës.

Majlinda Kaloshi thekson:- në qendër të regjistrimit të bizneseve në Han të Elezit figurojnë mbi pesëdhjetë biznese që janë të udhëhequra nga gratë dhe gjatë festës së tetë marsit kemi bërë një aktivitet si drejtori dhe ju kemi shpërndarë të gjitha bizneseve që udhëhiqen nga gratë lule dhe kartolinë të personalizuar. Për ndryshe ky është aktiviteti i parë gjatë vitit 2024 dhe në vitin 2023 kemi pasur aktivitete në kuadër të kësaj drejtori dhe ishin të orientuara për gjininë femërore , kursi për ajti, kursi për bletari dhe subvencione të ndryshme që i kemi pasur , ndërsa gjatë viti 2024 do të kemi mbështetje prej drejtorisë për bizneset fillestare. Si drejtori i ngarkojmë të gjitha subjektet afariste që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në territorin e komunës së Hanit të Elezit gjë që rezulton që ETC dhe Viva janë pjesë e kësaj ngarkese.

Abduraman Bushi thekson:- kemi ndarë 84 serra familjare sa ka qenë kërkesa, pas përfundimit të këtij afati kemi pasur kërkesa të reja që po i shqyrtojmë me shoqata të ndryshme dhe nëse gjejmë ndonjë donatorë do t'i shpërndajmë edhe tjerat. Sa i përket serrave ekonomike i kemi pasur dy kërkesa të cilat i kemi përcjell te Labi dhe kanë përfituar përmes Labit .

Refet Kalisi thekson:-projekti i hapjes së rrugës ka Terminali që ka stagnuar ku është problemi

Mehmet Ballazhi thekson:-projekti është dy vjeçar për shkak ikjes nga skenat filmike e politike që po zihen sepse unë nuk jam i skenave por unë jam i praktikave të punës dhe nuk po ngutemi se kemi afat të mjaftueshëm dhe ka qenë sezoni i dimrit që kompania nuk ka qenë aktive për me i kryer punët, jemi duke i pritur procedurat e KEDS-it që duhet të i ç'kyçin në mënyrë kolektive orët dhe pas mosfunksionimit të orëve të rrymës me vazhduar pastaj se është edhe një pjesë e murit mbrojtës në fazën e procedurave sepse nuk është paraprë ajo pjesë e murit dhe tash është në fazën e fundit të procedurave të prokurimit dhe me filluar pas procedurave që i udhëheqë KEDSI , me filluar largimin dal nga dal përmes kompanisë që ndoshta nuk kemi mjete të mjaftueshme. Përgjegjshmëria e pronarëve të lokaleve ishte dashur që me i ndihmuar procesit e jo me përfituar prej teorive të familjeve të dëshmorëve por është dashur me ndihmuar procesin për me i larguar për shkak se duhet të largohen. Në gjykatë kanë bërë ankesë dhe gjykata ua ka kthyer të pabazuar ankesën kështu që nuk ka diçka që mund të neglizhohet për arsye procedurale ligjore por vetëm për arsye teknike për ndryshe projekti vazhdon.

Kryesuesi thekson:- çështja e zgjedhjes së mësuesit më të mirë u potencua se çështjen e kritereve e ka përcaktuar Ministria e Arsimit por Drejtoria e Arsimit a ka pasur ndonjë farë kontrole dhe në çka jeni bazuar dhe për kënd bëhet fjalë.

Hisni Luri thekson:- kjo shkon në bazë të këshillit të arsimtarëve dhe këshilli i arsimtarëve e përzgjedhë dhe ne ja kemi përcjellë imellën që na i ka dërguar Ministria e Arsimit dhe e kanë përzgjedhë shkollat dhe shkollat ma kanë sjellë atë emër dhe nuk e kam përzgjedhur unë por e kanë përzgjedhur kriteret. Nëse doni me i ditur kriteret mundem me ua përcjell.

Kryesuesi thekson:-unë nuk potencova që ti e ke zgjedhur por me çfarë baze është zgjedhur

Hisni Luri thekson:- është zgjedhur në bazë të kritereve që i ka përcaktuar Ministria e Arsimit.

Kryesuesi thekson:- unë mendoj që nuk është bërë përzgjedhje e mirë e mësuesit më të mirë për shkak se nuk janë respektuar kriteret të një profesorit që ndoshta është dashur me ju shpallur vend i lirë i punës ashtu siç ja keni shpallur z.Jumni Thaçi por ju e zgjidhni profesor më të mirë të komunës mendoj që nuk është e drejtë kjo dhe potencohet këtu që nuk ka pasur ankesa dhe do të ishte më e drejtë me biseduar pak më ndryshe.

Hisni Luri thekson:-i nderuar Kryesues me gjithë respektin sinqerisht nuk mundem me ju kuptuar se ankesat a duhet të jenë nga Kuvendi i Komunës apo duhet të jenë nga arsimtarët . Sa i përket pjesës që me ja rishpallë vendin e punës , i ka mbi dhjetë vite përvojë pune dhe kjo nuk na lejohet.

Kryesuesi thekson:- nuk është mirë me gënjyer opinionin për shkak se ke mbajtur takim me gjithë drejtorët por edhe drejtorët gati se janë rrahur në zyrën tënde dhe këtë duhet ta pranosh se po më detyron me potencuar por diçka më çuditë se prej z.Faruk Berisha u frigove që pa tjetër me zgjedhë profesor më të mirin personin në fjalë apo prej kujt u frigove.

Hisni Luri thekson:-i nderuar Kryesues unë nuk e kam përzgjedhur por e ka përzgjedh komisioni dhe kriteret, nuk i frikohem askujt por drejtorët të cilët ishin pjesëmarrës ishin vetëm për hir të transparencës dhe nuk kanë pasur ndonjë far indikator por e kanë kryer punën e vetë për shkak se drejtorët i kanë sjellë emrat që i kanë përzgjedhur përmes këshillit të mësimdhënësve dhe nuk e di se çka me shtuar më shumë te kjo pjesë , mirëpo po më vjen keq se nga një herë se i paragjykojmë për shkak se nuk ka qenë tu rrahur as kush dhe nëse dalim tash dhe potencojmë se në Kuvendë janë kanë tu rrahur se ka debatuar kryesuesi me drejtori nuk po më duket interesantë.

Kryesuesi thekson:- unë mendoj se ju keni ndikuar në përzgjedhjen e arsimtarit për deri sa ty e ke hapur si diskutim në prezencë të komisionit, në prezencë të drejtorëve dhe kjo është një farë forme që ke ndikuar se nuk e di se çka të lidhë me të a vetëm shoqëria apo edhe ndonjë send tjetër nuk e di por shpresoj që në të ardhmen mos me pasur kësi gjëra.

Mehmet Ballazhi thekson:- për shkak se nuk përputhen interesat politike dali edhe këto probleme dhe mos pajtime dhe zakonisht këto zihen e përzihen në kazanat e kafeve dhe interesat politike të grupeve të caktuara të ndryshme për interesa të vogla banale nëpër kafe. Ne po flasim për procedura, po flasim për ligje, po flasim për institucione dhe nëse potencohet se një institucion e ka përzgjedhur një profesor më të mirin janë procedurat, janë kriteret dhe debatet që bëhen nëpër kafe janë të pa pranueshme dhe janë çorientim dhe dezinformim i qytetarit.

Kryesuesi thekson:- unë mendoj që këtu vetëm procedurë nuk ka pasur dhe procedura nuk është respektuar e na detyrohemi këtu me potencuar se nuk është mirë me u zgjedhur në këtë formë me marr një titull pa meritë.

Mehmet Ballazhi thekson:-kur potencojmë që nuk ka pasur procedurë ku pe dini që nuk ka pasur dhe asnjë procedurë nuk po e potenconi që ka ndodhë apo nuk ka ndodhur. Nëse mendoni që ju ka bërë e pa drejtë dhe ty doni me ja mbrojtur të drejtën dikujt pajtona por filloni me procedura e jo me mikrofon këtu në Kuvend sepse është mos informim i saktë i qytetarëve. Ka dihet që nuk është udhëhequr asnjë procedurë se kriteret , propozimi janë zbatuar dhe pse potencohet që pa procedurë.

Kryesuesi thekson:- ata e dinë më së miri se si është zgjedhur por për deri sa hapet kjo temë para komisionit dhe para drejtorëve nga drejtori DKA-së këtu është ndikuar kjo punë.

Sherif Berisha thekson:- në faqe të shkollës fillore është publikuar një person tjetër, ndërsa më i miri është shpallur një person tjetër.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket paneleve solare ka interesim të kompanive për ndërtim të paneleve solare dhe turbinave me erë këto janë për treg për shitje por ne nuk kemi mundur me dhënë pëlqim për shkak se në Plan Zhvillimorë Komunal nuk janë paraparë për shkak se plani ekzistues zhvillimorë është miratuar në vitin 2011 dhe nuk kanë qenë atraktive panelet solare dhe turbinat me erë por kohët e fundit ka shumë interesim. Me planin zhvillimorë të komunës të cilin e kemi përfunduar kemi paraprë edhe në përfundim te pjesa ka Neqafci por edhe në Zheden dhe Pusteni për turbina me erë dhe panele solare. Sa i përket qytetarëve është çështje individuale dhe është diçka shumë e mirë por me planin lokal për cilësi të ajrit ne i kemi bërë disa kalkulime se një pjesë përdorin për ngrohje drutë është e dëmshme, ndërsa peleti është më pak i dëmshëm për shkak se ai djegat më shumë pra plotësisht digjet por gjatë hartimit të planit lokal për cilësi të ajrit kemi pasur një ekspertë prej Japonisë dhe i kanë bërë disa kalkulime dhe ne e kemi paraparë që për vitet e ardhshme nëse 200 shtëpi kalojnë prej ngrohjes me dru me pelet atëherë 11.8 tona në vit do të ulet ndotja nga PM 2.10 dhe kështu ndikon por më e mira është me rrymë elektrike sepse edhe veleti ka ndotje por më pak se druri. Me plan e kemi të parapri që gjitha objektet publike nëse kemi donacione me vendosur panele solare.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj nga drejtoria për Shëndetësi se pse nuk njoftohet nga tekniku që nuk është e hapur AMF në fshatin Gorancë dhe pse nuk njoftohen në ato ditë që është e hapur. Kërkoj ta dijë arsyen.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- sa i përket mjekut me Islamik Reliefë fatkeqësisht pasi që ka filluar punën ka dhënë dorëheqje për arsye personale që ja ka paraqitur Islamik Reliefit. Nuk kam informacione zyrtarë për AMF-në që nuk ka punuar.


Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:53.

Procesmbajtësi

Arta Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

